

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

E nderuar, zonja Kryetare Kuvendit.

Të nderuar kolegë deputetë,

Personalisht, do të doja që seanca e sotme dhe e gjithë koha e diskutimit deri në miratimin e buxhetit për vitin 2022, të kishte sa më pak propagandë dhe retorikë pa vlerë. Të gjithë së bashku të projektonim një buxhet efektiv dhe shpresëdhënës për qytetarët, por me sa u demonstrua nga diskutimet e deritanishme, gjithçka është e paracaktuar, duke kuptuar se çfarëdo propozimi të bëjmë ne, do të ketë vlerë vetëm për këtë seancë dhe për arkivat e Kuvendit, pasi nuk ka gjasë që qeveria të marrë në konsideratë propozimet, sepse kjo qasje ka qenë nga ana e saj në diskutimet e komisioneve parlamentare. Ky projektbuxhet, për të cilin ne nisim diskutimin sot në seancë plenare, vjen në një moment shumë kritik për realitetin e qytetarëve tanë, kur jetesa e tyre është bërë e papërballueshme me të ardhurat që sigurojnë; kur çmimet e produkteve bazë po rriten ditaditës; kur çmimi e karburantit dhe i gazit është rritur; kur një krizë energjetike, e shkaktuar nga keqmenaxhimi i sektorit, pritet të sjellë rritjen e çmimit të energjisë për biznesin e madh, i cili do të rrisë koston e shërbimeve dhe, automatikisht, do të përkthehet në më shumë para nga xhepat e qytetarëve. Ky buxhet vjen në momentin kur pagat e qytetarëve janë ndër më të ulëtat në rajon, kur varfëria është ulur këmbëkryq, duke na renditur si vendi më i varfër në rajon, sipas Bankës Botërore.

Sipas Eurostat-it, 50% e shqiptarëve po jetojnë në varfëri dhe, sipas Save the Children, 50% e fëmijëve po rriten në varfëri. Duke e ditur këtë realitet, do të doja të kishim një buxhet realist, që të adresonte krizën e rëndë ekonomike dhe sociale në të cilën ndodhet vendi, një buxhet të fokusuar te ndihma ndaj të varfërve, ndaj shtresave në nevojë; një buxhet në rritje për arsimin apo insentiva konkrete për hapjen e vendeve të reja të punës, mbi të gjitha, për të rinjtë që sot zgjedhin emigracionin dhe jo vendin e tyre për të ndërtuar të ardhmen. Unë nuk e di se ku jeton kjo qeveri, por në Shqipëri nuk besoj, sepse të shqetësohesh për financimin e PPP-ve dhe jo për ekonominë e familjeve shqiptare, të cilët mezi ia dalin çdo muaj, do të thotë se qartazi vazhdoni të qeverisni për interesat e disave dhe jo të qytetarëve tuaj. Punësimi është sot shqetësimi kryesor i çdo qytetari. Mungesa e vendeve të punës dhe pagat e ulëta nuk sigurojnë të ardhura të mjaftueshme që të rinjtë të krijojnë familje. Rritja ekonomike imagjinare nuk përkthehet në punësim dhe mirëqenie për qytetarët, por i drejton ata drejt emigracionit. Në këtë varfëri, që ka pushtuar vendin, pse ne ende nuk llogarisim minimumin jetik, siç bën e gjithë bota e qytetëruar? Kur ka menduar kjo qeveri ta llogarisë? Në bazë të minimumit jetik mund të ndërmerren të gjitha politikat dhe vendimmarrjet, për të pasur një standard jetese të caktuar për çdo qytetar, të cilin ky shtet duhet ta sigurojë për të pasur një jetë dinjitoze në këtë vend. Nëse e shikoni programin jo vetëm nuk njihet problemi i papunësisë, por në të thuhet se 11% e të rinjve janë të papunë. Kjo është qesharake dhe nuk adreson problemin e papunësisë me politika konkrete për të stimuluar hapjen e vendeve të reja të punës.

Arsimi propagandohet si prioritet, por në programin qeverisës nuk kishte asnjë shifër për ta mbështetur me buxhet. Në buxhetin e vitit 2022 nuk ka rritje të mbështetjes buxhetore për arsimin, të paktën, sa rajoni. Ndërkohë, ky sektor po përballlet sot me sfida jo vetëm të dijës, të kurrikulave, të cilësisë së mësimdhënies, të infrastrukturës së munguar, të platformave online, që dështuan në

mënyrë spektakolare në kohë pandemie, por edhe me probleme sociale. Rasti i fundit, i drejtorit të shkollës në Pogradec, i cili ngacmonte seksualisht 2 të mitura, ishte një kampanë alarmi, që duhen të ndërmerren masa të menjëhershme për të forcuar këto institucione, për të luftuar këto fenomene të tmerrshme dhe për të rritur sigurinë në shkollat tona. Ne duhet t'i edukojmë fëmijë me kulturë qytetare, t'i dinë të drejtat e tyre dhe t'i mbrojnë ato. Punonjësit e arsimit duhen ndërgjegjësuar për rolin që duhet të kryejnë në adresimin e rasteve të dhunës apo të ngacmimeve seksuale. Shkollat tona nuk duhet të jenë thjesht institucione të dhënies së dijes, sepse janë qendra tejet të rëndësishme për formimin e qytetarit të së nesërme. Ne duhet të vendosim në kurrikul edukimin qytetar, me prioritet shumë më të fortë dhe të strukturuar, më të fortë se sot.

Uroj që zonja ministre, e cila është e pranishme, ta marrë në konsideratë këtë sugjerim, pasi mendoj se kur flasim për fëmijët tanë, bashkohemi të gjithë për sigurinë dhe edukimin e tyre. Ne duhet ta kemi prioritet kombëtar arsimin, pasi pa edukim cilësor, të lidhur me tregun e punës, nuk mund të ndërtojmë dhe të zhvillojmë ekonominë e Shqipërisë të së nesërme. Unë do të preferoj të ndërtohen 2 rrugë më pak dhe më shumë shkolla, paga të larta dhe më dinjitoze për mësuesit tanë, kurrikula të standardeve dhe të forcimit të arsimit profesional, me programe të dedikuara për punësimin e të rinjve gjatë zhvillimit të mësimin, sipas modelit "mëso dhe fito". Një sektor tjetër, që nuk po mbështet nga ky buxhet është biznesi i vogël familjar, që u përballi vetëm me krizën e pandemisë dhe me lëmoshat e kësaj qeverie. Sot motorët e ekonomisë janë gjysmë të ndezur dhe nuk ka asnjë plan shpëtimi. Borxhi publik po rritet, duke kapur sot 80% të PBB-së.

Nga ana tjetër, shpopullimi po krijon jo vetëm dramë familjare dhe sociale, por edhe krizë të burimeve njerëzore, pasi po ikin profesionistët e rinj. Në përfundim, pasi ju ta keni votuar këtë buxhet, nuk do të ndryshojë asgjë. Varfëria do t'i bëjë edhe më të varfër ata që jetojnë në të sot. Oligarkët dhe klientët e pushtetit do të vazhdojnë të pasurohen nën kujdesin dhe mbrojtjen e qeverisë. Të rinjtë, por edhe të tjerët, do të vazhdojnë të ikin, duke e thelluar më shumë plagën e madhe të shpopullimit, të cilën nuk mund ta mbyllë dhe ta shërojë Ballkani i hapur apo hedhja në orbitë e satelitit të premtuar në programin 4-vjeçar të qeverisë. Faleminderit!